

**Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e  
Legjislacionit Mjedisor**

*Një projekt për Shqipërinë financuar nga Bashkimi Evropian*

**Projekt**

**VKM për Trajtimin<sup>1</sup> e Ujërave të Përdorur Urbanë**

**Drafti 1**

**Versioni 1**

**6 Gusht 2010**

---

<sup>1</sup> Ky Vendim transponon Direktivën 91/271/EEC Për Trajtimin e Ujërave të Përdorur Urbanë, amenduar nga Direktiva 98/15/EC, Rregullorja EC/1882/2003 dhe Rregullorja EC/1137/2008



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM**

*(Drafti 1 Versioni 1 i datës 6 Gusht 2010)*

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

**Për**  
**Trajtimin<sup>2</sup> e Ujërave të Përdorur Urbanë**

Në mbështetje të Nenit 100 të Kushtetutës dhe Nenit xxxx të Ligjit nr \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ “Për Menaxhimin e Integruar të Ujërave”, Këshilli i Ministrave;

**VENDOSI:**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky Vendim përcakton kërkesat minimale për grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të përdorur urbanë, me qëllim mbrojtjen e mjedisit nga efektet negative të tyre.

**II. Përkufizime**

2. Për qëllime të këtij Vendimi, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

---

<sup>2</sup> Ky Vendim transponon Direktivën 91/271/EEC Për Trajtimin e Ujërave të Përdorur Urbanë, amenduar nga Direktiva 98/15/EC, Rregullorja EC/1882/2003 dhe Rregullorja EC/1137/2008

- a. **“Aglomerat”** është zona ku popullsia dhe/ose aktivitetet ekonomike janë të përqëndruar në atë masë që justifikon që ujërat e përdorur urbanë të grumbullohen dhe dërgohen në një impiant për trajtimin e ujërave të përdorur urbanë apo në një pikë shkarkimi përfundimtar;
  - b. **“Trajtim i përshtatshëm”** është trajtimi i ujërave të përdorur urbanë nga çdo proces dhe/ose sistem asgjësimi, i cili pas shkarkimit lejon ujërat pritëse të plotësojnë normat përkatëse të cilësisë për ujin të përcaktuara në bazë të Nenit xxx të Ligjit “Për Menaxhimin e Integruar të Ujërave”, dhe të plotësojë dispozitat përkatëse të këtij Vendimi dhe të Ligjit “Për Menaxhimin e Integruar të Ujërave”;
  - c. **“Sistem grumbullimi”** është sistemi i kanalizimeve/ tubacioneve që bëjnë grumbullimin dhe largimin e ujërave të përdorur urbanë;
  - d. **“Ujëra të përdorur shtëpiakë”** janë ujërat e përdorur nga qendrat e banimit dhe shërbimet me origjinë kryesisht nga metabolizmi njerëzor dhe aktivitetet shtëpiake;
  - e. **“Leje Mjedisit”** është leja e Tipit A, B ose C në përputhje me Ligjin Nr \_\_\_\_, datë \_\_\_\_ “Për Lejet e Mjedisit”;
  - f. **“Grykëderdhje e gjerë”** është pjesa e grykëderdhjes së një lumi me veti në tranzicion midis ujërave të ëmbël dhe ujërave bregdetarë;
  - g. **“Eutrofikim”** është pasurimi i ujërave me lëndë ushqyese, veçanërisht përbërje azoti dhe/ose fosfori, që shkakton rritje të përshpejtuar të algave dhe formave të tjera të jetës bimore që sjellin çrregullime të padëshiruara në balancën e organizmave të pranishëm në ujë dhe në cilësinë e ujërave që lidhen me to;
  - h. **“Ujëra të përdorur industriale”** janë të gjithë ujërat e ndotur që shkarkohen nga vendet e përdorura për tregti apo industri, përveç ujërave të përdorur shtëpiakë dhe ujërave kulluese të shiut;
  - i. **“Trajtim sekondar”** është trajtimi i ujërave të përdorur urbanë nëpërmjet një procesi që në përgjithësi përfshin trajtimin biologjik sekondar apo proces tjetër, gjatë të cilit respektohen kërkesat e përcaktuara në Tabelën 1 të Aneksit I;
  - j. **“Llum”** është llumi i mbetur, i trajtuar apo i patrajtuar, nga impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur urbanë;
  - k. **“Ujëra të përdorur urbanë”** janë ujërat e përdorur shtëpiakë apo përzierja e ujërave të përdorur shtëpiakë me ujërat e përdorur industrial dhe/ose ujërat kulluese të shiut;
  - l. **“1 ekuivalent popullsie (p.e.)”** është ngarkesa organike e biodegradueshme që ka kërkesë biokimike pesë ditore për oksigjen (BOD5) prej 60 g oksigjen në ditë. Ngarkesa llogaritet në bazë mesatare maksimale të ngarkesës javore që hyn në impiantin e trajtimit gjatë vitit, duke përjashtuar situatat e pazakonta siç janë rastet me shira të dendur.
3. Të gjithë termat e tjerë të përdorur në këtë Vendim kanë kuptimin që u është dhënë nga Ligji “Për Menaxhimin e Integruar të Ujërave”.

### III. Përcaktimi i aglomeratëve

4. Ministri, pasi konsultohet me Ministrin përgjegjës për planifikimin e territorit dhe Ministrin përgjegjës për punët publike, nxjerr një Urdhër me të cilin miraton klasifikimin e aglomerateve sipas madhësisë së ekuivalentit të popullsisë në mënyrë që të plotësohen kërkesat e këtij Vendimi.
5. Klasifikimi i referuar në Paragrafin 4 rishqyrtohet dhe, nëse është e nevojshme rishikohet, çdo katër vjet.
6. Urdhri i referuar në Paragrafët 4 dhe 5 botohet në Fletoren Zyrtare.

### IV. Përcaktimi i zonave sensitive

7. Ministri, pasi konsultohet me Këshillin përkatës të Bazenit të Lumit, përcakton me Urdhër zonat sensitive në përputhje me kriteret e përcaktuara në Aneksin II.
8. Zonat sensitive duhen përcaktuar deri në 31 Dhjetor 2013 [për këtë datë duhet rënë dakord – kjo datë përputhet me rishqyrtimin çdo 4 vjet siç kërkohet nga Direktiva].
9. Ministri rishqyrton përcaktimin e zonave sensitive jo më vonë se data 31 Dhjetor 2017 dhe më pas periodikisht në interval prej jo më shumë se katër vjetësh.
10. Urdhërat e referuara në Paragrafët 7 dhe 9 botohen në Fletoren Zyrtare.

### V. Detyrimi për të siguruar dhe mirëmbajtur sistemet kolektore

11. Të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore [apo autoriteti që kërkohet të sigurojë sistemet kolektore] garantojnë që sistemet kolektore janë siguruar:
  - a. Në rastet e shkarkimit të ujërave të përdorur urbanë në ujërat pritëse që ndodhen në zonë sensitive, deri më 31 Dhjetor *viti* [data e direktivës plus 7 vjet];
  - b. Pavarësisht nga nën-paragrafi (a);
    - i. Deri më 31 Dhjetor *viti* [data e direktivës plus 9 vjet] për çdo aglomerat me ekuivalent popullsie prej më shumë se 15,000;
    - ii. Deri më 31 Dhjetor *viti* [data e direktivës plus 14 vjet] për çdo aglomerat me ekuivalent popullsie midis 2,000 dhe 15,000.
12. Paragrafi 11 nuk zbatohet në rastet kur ose:
  - a. Këshilli përkatës i Bazenit të Lumit [Agjencia Kombëtare e Mjedisit?] ka vërtetuar që ndërtimi i një sistemi kolektor nuk justifikohet pasi nuk do të sillte përfitime mjedisore; apo
  - b. Ministri ka vërtetuar që ndërtimi i një sistemi kolektor nuk justifikohet pasi do të kishte kosto të tepërta.

13. Në rastet kur zbatohet Paragrafi 12, sistemet individuale apo sisteme të tjerë të përshtatshëm duhen siguruar dhe Këshilli përkatës i Bazenit të Lumit [Agjencia Kombëtare e Mjedisit?] ka vërtetuar që këto sisteme arrijnë të njëjtin nivel mbrojtjeje të mjedisit siç kërkohet në Paragrafin 11.
14. Sistemet kolektore të referuar në Paragrafin 11, plotësojnë të paktën kërkesat e mëposhtme:
- a. Sistemet kolektore marrin në konsideratë kërkesat për trajtimin e ujërave të përdorur;
  - b. Projekti, ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve kolektore ndërmerren në përputhje me njohuritë më të mira teknike pa sjellë kosto të tepërta, sidomos përsa i përket:
    - i. Vëllimit dhe karakteristikave të ujërave të përdorur urbanë;
    - ii. Parandalimi i rrjedhjeve;
    - iii. Kufizimi i ndotjes së ujërave pritëse për shkak të vërshimeve të ujërave nga stuhitë.

#### **VI. Detyrimi për të siguruar dhe mirëmbajtur impiantet e trajtimit**

15. Të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore [ose autoriteti që duhet të sigurojë impiante trajtimi] ngrenë impiante trajtimi në mënyrë që ujërat e përdorur urbanë që hyjnë në sistemin kolektor, para shkarkimit, t'i nënshtrohen të paktën trajtimit sekondar apo një trajtimi të ngjashëm:
- a. Deri më 31 Dhjetor *viti* [data e direktivës plus 9 vjet] për të gjitha shkarkimet nga aglomeratët me ekuivalent popullsie prej më shumë se 15,000;
  - b. Deri më 31 Dhjetor *viti* [data e direktivës plus 14 vjet] për të gjitha shkarkimet nga aglomeratët me ekuivalent popullsie midis 10,000 dhe 15,000;
  - c. Deri më 31 Dhjetor *viti* [data e direktivës plus 14 vjet] për të gjitha shkarkimet në ujëra të ëmbla dhe grykëderdhje nga aglomeratët me ekuivalent popullsie midis 2,000 dhe 10,000.
16. Shkarkimet e ujërave të përdorur urbanë në ujëra në zonat me male të larta që shtrihen mbi 1,500m mbi nivelin e detit dhe në rastet kur, sipas mendimit të Ministrit, është e vështirë të zbatohet trajtim biologjik efektiv për shkak të temperaturave të ulëta, mund t'i nënshtrohen trajtimeve më pak të rrepta se sa ato të përshkruara në Paragrafin 14, me kusht që studime të hollësishme të tregojnë se këto shkarkime nuk kanë efekte negative mbi mjedisin.
17. Sipas Paragrafit 18, impiantet e trajtimit që sigurojnë trajtim më të rreptë se sa ai që përshkruhet në Paragrafin 15 duhen siguruar deri më 31 Dhjetor *viti* [data e direktivës plus 7 vjet] në lidhje me të gjitha shkarkimet nga aglomeratët me ekuivalent popullsie prej më shumë se 10,000 në zonat sensitive, apo në basenet përkatëse ujëmbledhëse të zonave sensitive në rastet kur shkarkimet kontribuojnë në ndotjen e këtyre zonave.

18. Paragrafi 17 nuk zbatohet në një zonë sensitive kur Ministri [Këshilli i Bazenit të Lumit][AKM] përmes monitorimit provon se mund të sigurojë që përqindja minimale e pakësimit të ngarkesës totale që hyn në të gjithë impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur urbanë në atë zonë, dhe në të gjithë impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur urbanë në rajonet ujëmbledhëse të zones, shkarkimet e të cilëve kontribuojnë në ndotjen e zonës, është të paktën 75% për fosforin total dhe të paktën 75% për azotin total.
19. Në rastet kur, pas rishqyrtimit të bërë sipas Paragrafit 9, një zonë klasifikohet si sensitive, atëherë sipas rastit për atë zonë për shtatë vjet nga data e identifikimit zbatohen dispozitat e Paragrafëve 17 ose 18.
20. Të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore [ose autoriteti që duhet të sigurojë impiantet e trajtimit] ngrenë impiante trajtimi në mënyrë që ujërat e përdorur urbanë që hyjnë në sistemet kolektore përpara shkarkimit deri më 31 Dhjetor *viti [data e direktivës plus 14 vjet ]* t'i nënshtrihen një trajtimi të përshtatshëm të paktën në lidhje me:
- a. shkarkimet në ujëra të ëmbla dhe grykëderdhje të gjera nga aglomeratët me ekuivalent popullsie prej më pak se 2,000; dhe
  - b. shkarkimet në ujërat bregdetare nga aglomeratët me ekuivalent popullsie prej më pak se 10,000.
21. Impiantet e trajtimit të referuara në këtë Pjesë për të garantuar performancë të mjaftueshme nën të gjitha kushtet klimaterike lokale projektohen, ndërtohen, operohen dhe mirëmbahen. Gjatë projektimit të impianteve të trajtimit merren në konsideratë të gjitha ndryshimet sezonale të ngarkesave.

#### **VII. Shkarkimet e ujërave të përdorur urbanë të trajtuar**

22. Agjencia Kombëtare e Mjedisit garanton që leja e mjedisit e Tipit B për impiantet e trajtimit referuar në Pjesën VI përmban kushte të tilla që plotësojnë kërkesat përkatëse të Aneksit I.

#### **VIII. Shkarkimet e ujërave të përdorur industrialë në sistemet kolektore apo impiantet e trajtimit**

23. Agjencia Kombëtare e Mjedisit apo Agjencia Rajonale e Mjedisit sipas rastit, garanton që leja përkatëse e mjedisit për shkarkimin e ujërave të përdorur industrialë në sistemet kolektore apo impiantet e trajtimit përmban kushtet të tilla që plotësojnë kërkesat e Aneksit III.

#### **IX. Shkarkimet e disa ujërave të përdorur industrialë në ujërat pritëse**

24. Agjencia Kombëtare e Mjedisit apo Agjencia Rajonale e Mjedisit sipas rastit, garanton që leja përkatëse e mjedisit për shkarkimin e ujërave të përdorur industrialë të biodegradueshëm nga impiantet që përfaqësojnë një ekuivalent popullsie të barabartë ose më të madh se 4,000 apo që i përkasin sektorëve industrialë të listuar në Aneksin IV që nuk hyjnë në impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur urbanë

përpara shkarkimit në ujërat pritëse, përmban kushte që janë të përshtatshme për natyrën e industrisë në fjalë për shkarkimin e ujërave të tillë të përdorur.

#### **X. Kërkesat për përdorimin e llumit**

25. Asgjësimi në ujërat sipërfaqësore përmes shkarkimit në to i mbetjeve nga anijet, i llumrave nga shkarkimet, nga tubacionet apo nga çdo lloj mjeti tjetër është i ndaluar. [duhet kontrolluar nëse kjo gjë është ndërkohë e ndaluar – nëse jo mund të ketë nevojë për periudhë tranzicioni – shih direktivën Neni 14(3) dhe (4)]
26. Llumi ripërdoret sa herë që është e mundur. Rrugët për asgjësimin e tij duhet të minimizojnë efektet negative në mjedis.
27. Agjencia Kombëtare e Mjedisit apo Agjencia Rajonale e Mjedisit sipas rastit, garanton që leja përkatëse e mjedisit për ripërdorimin e llumit përmban kushtet të tilla që plotësojnë kërkesat e Paragrafit 26.

#### **XI. Kërkesat për ripërdorimin e ujërave të përdorur të trajtuar**

28. Ujërat e përdorur të trajtuar ripërdoren sa herë që është e mundur. Rrugët për asgjësimin e tyre duhet të minimizojnë efektet negative në mjedis.

29. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton standardet dhe kërkesat për ripërdorimin e ujërave të përdorur të trajtuar.

#### **XII. Ndotja ndërkufitare**

30. Në rastet kur ujërat në jurisdiksonin e Republikës së Shqipërisë ndikohen negativisht nga shkarkimet e ujërave të përdorur urbanë nga një Shtet tjetër, apo në rastet kur shkarkimet e ujërave të përdorur urbanë të Republikës së Shqipërisë ndikojnë negativisht në ujërat në jurisdiksonin e një Shteti tjetër, Ministri koordinon përpjekjet për identifikimin e shkarkimeve në fjalë dhe të masave që duhen marrë në burim me qëllim mbrojtjen e ujërave që janë ndikuar për të siguruar respektimin e kërkesave të këtij Vendimi.

#### **XIII. Monitorimi**

31. Agjencia Kombëtare e Mjedisit monitoron shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur urbanë për të verifikuar respektimin e kërkesave të lejes së mjedisit dhe për të verifikuar respektimin e kërkesave të Pjesës A të Aneksit I në përputhje me procedurat e kontrollit të përcaktuara në Pjesën B të Aneksit I.
32. Agjencia Kombëtare e Mjedisit [Këshilli i Bazetit të Lumit?] monitoron ujërat që i nënshtrohen shkarkimeve nga impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur urbanë.
33. Agjencia Kombëtare e Mjedisit [dhe REA?] [Këshilli i Bazetit të Lumit?] monitoron ujërat që i nënshtrohen shkarkimeve të drejtpërdrejta nga ujërat e përdorur industrialë sipas Paragrafit 24.

34. Autoritetet e referuara në Paragrafët 31, 32 dhe 33 mbajnë informacionin e mbledhur prej tyre dhe e venë në dispozicion të Ministrit me kërkesën e tij.

35. Ministri, nxjerr një Urdhër ku miraton udhëzimet për monitorimin e referuar në këtë Pjesë botohet në Fletoren Zyrtare,.

#### **XIV. Programi i Zbatimit**

36. Ministri, pas konsultimit me [kë?], harton programin për zbatimin e këtij Vendimi.

37. Programi i referuar në Paragrafin 36 përgatitet brenda dy vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi.

38. Ministri rishqyrton dhe vlerëson zbatimin e programit çdo dy vjet dhe më pas boton raportin përkatës.

39. Ministri, nxjerr një Urdhër ku miraton metodat dhe formatet e raportimit për zbatimin e programit. Ky Urdhër botohet në Fletoren Zyrtare,.

40. Raportet e referuara në Paragrafin 38 vihen në dispozicion të publikut.

#### **XV. Dispozita Përfundimtare**

41. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për miratimin e akteve normative për zbatimin e Paragrafit 29.

42. Ministri është përgjegjës për miratimin e akteve normative për zbatimin e Paragrafëve 6, 10, 35 dhe 39.

43. Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Këshilli Kombëtar i Ujërave dhe Këshillat e Bazeneve të Ujërave janë përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi.

44. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**SALI BERISHA**



## Aneksi I. Kërkesat për ujërat e përdorur urbanë

### Pjesa A. Kërkesat për shkarkimet nga impiantet e trajtimit në ujërat pritëse

1. Impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur projektohen ose modifikohen në mënyrë të tillë që kampionët përfaqësues të ujërave të përdorur ardhës dhe të rrjedhjeve të trajtuara mund të përftohen përpara shkarkimit në ujërat pritëse.
2. Shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur urbanë që i nënshtrohen trajtimit në përputhje me Paragrafët 15 dhe 17, subjekt i Paragrafëve 4 dhe 5 të pjesës B të këtij Aneksi, plotësojnë kërkesat e treguara në Tabelën 1.
3. Shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur urbanë në ato zona sensitive që i nënshtrohen trofikimit siç identifikohet në Aneksin II pika (a) plotësojnë gjithashtu kërkesat e treguara në Tabelën 2 të këtij Aneksi.
4. Në rastet kur kërkohet të garantohet që ujërat pritëse plotësojnë çdo kërkesë tjetër të legjislacionit përkatës zbatohen kërkesa më të rrepta se sa ato të treguara në Tabelën 1 dhe/ose Tabelën 2 zbatohen.
5. Pikat e shkarkimit të ujërave të përdorur urbanë zgjidhen, sa të jetë e mundur, në mënyrë të tillë që të minimizohen efektet në ujërat pritëse.

**Tabela 1. Kërkesat për shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur urbanë subjekt i Paragrafëve 15 dhe 17**

Parametrat	Përqendrimi	Përqindjet minimale të pakësimit <sup>(1)</sup>	Metoda referencë për matjen
Kërkesa biokimike për oksigjen (BOD5 në 20°C pa nitrifikim <sup>(2)</sup> )	25 mg/l O2	70-90	Kampion i homogjenizuar, i pafiltruar, i padekantuar. Përcaktimi i oksigjenit të tretur përpara dhe pas inkubacionit pesë ditor në 20°±1°C, në errësirë të plotë. Shtimi i një agjenti frenues nitrifikimi
Kërkesa kimike për oksigjen (COD)	125 mg/l O2	75	Kampion i homogjenizuar, i pafiltruar, i padekantuar. Dikromat kaliumi
Totali i trupave të ngurtë pezull	35 mg/l <sup>(3)</sup>	90 <sup>(3)</sup>	- Filtrimi i një kampioni përfaqësues nëpërmjet një membrane filter 0,45µm. Tharja në 105 °C dhe peshimi - Centrifugimi i një kampioni përfaqësues (për të paktën pesë minuta me nxitim mesatar prej 2800 deri në 3200 g),
	35 në bazë të Paragrafit 16 (më shumë se 10 000 e.p.)	90 në bazë të Paragrafit 16 (më shumë se 10 000 e.p.)	
	60 në bazë të Paragrafit 16 (2 000 deri në 10 000 e.p.)	70 në bazë të Paragrafit 16 (2 000 deri në 10 000 e.p.)	

Parametrat	Përqendrimi	Përqindjet minimale të pakësimit <sup>(1)</sup>	Metoda referencë për matjen
			tharja në 105°C dhe peshimi

Aplikohen vlerat për përqendrimin ose për përqindjen e pakësimit.

Analizat në lidhje me shkarkimet nga lagunizimi kryhen me kampionë të filtruar; megjithatë, përqendrimi i totalit të trupave të ngurtë pezull në kampionet me ujë të pafiltruar nuk duhet të tejkalojë 150 mg/l.

Shënime për Tabelën 1.

- (1) Pakësimi në lidhje me ngarkesën e derdhjeve
- (2) Ky parametër mund të zëvendësohet nga një parametër tjetër: karboni total organik total (TOC) ose kërkesa totale për oksigjen (TOD) nëse mund të ndërtohet një marrëdhënie midis BOD5 dhe parametrin zëvendësues.
- (3) Kjo kërkesë është opsionale

**Tabela 2. Kërkesat për shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujrave të përdorur urbanë në ato zona sensitive që i nënshtrohen trofikimit siç identifikohen në Aneksin II pika (a)**

Parametrat	Përqendrimi	Përqindja minimale e pakësimit <sup>(1)</sup>	Metoda referencë e matjeve
Fosfori total	2 mg/l (10 000 deri në 100 000 e.p.)	80	Spektrofotometri i absorbimit molekular
	1 mg/l (më shumë se 100 000 e.p.)		
Azoti <sup>(2)</sup> total	15 mg/l (10 000 deri në 100 000 e.p.) <sup>(3)</sup>	70-80	Spektrofotometri i absorbimit molekular
	10 mg/l (më shumë se 100 000 e.p.) <sup>(3)</sup>		

Një ose të dy parametrat mund të aplikohen në varësi të situatës lokale.

Aplikohen vlerat për përqendrimin ose për përqindjen e pakësimit.

Shënime për Tabelën 2.

- (1) Pakësimi në lidhje me ngarkesën e derdhjeve
- (2) Azoti total është shuma e azotit total Kjeldahl (azoti organik dhe amoniakut) nitratet-azotit dhe nitritet-azotit.
- (3) Këto vlera për përqendrimin janë mesataret vjetore siç referohen në Pjesën B paragrafi 4(c) të këtij Aneksi. Megjithatë, kërkesat për azot, mund të kontrollohen duke përdorur mesataret ditore kur provohet, në përputhje me Pjesën B paragrafi 1, që përftohet i njëjti nivel mbrojtjeje. Në këtë rast, mesatarja ditore nuk duhet të tejkalojë 20 mg/l të azotit total për të gjitha kampionet kur temperatura nga rrjedhjet në reaktorin biologjik është më e lartë ose e barabartë me

12 °C. Kushtet në lidhje me temperaturën mund të zëvendësohen nga kufizimi në kohë i operimit për të marrë në konsideratë kushtet klimaterike rajonale.

## **Pjesa B. Metodatat referencë për monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve**

1.
  - a. Agjencia Kombëtare e Mjedisit aplikon një metodë monitoruese që korrespondon të paktën me nivelet e kërkesave të përshkruara më poshtë.
  - b. Metodatat alternative për ato të përmendura në paragrafët 2, 3 dhe 4 mund të përdoren me kusht që të demonstron që përfitohen rezultate ekuivalente.
  - c. Agjencia Kombëtare e Mjedisit i jep Ministrit të gjithë informacionin përkatës në lidhje me metodën e aplikuar.
2.
  - a. Kampionet proporcionale me rrjedhjen ose kampionet me bazë kohore prej 24 orësh merren në të njëjtën pikë të mirë-përcaktuar në grykëderdhje dhe nëse është e nevojshme në hyrje të impiantit të trajtimit me qëllim monitorimin e respektimit të kërkesave për shkarkimin e ujërave të përdorur të parashtruara në këtë Vendim.
  - b. Praktikatat e mira laboratorike ndërkombëtare që synojnë minimizimin e degradimit të kampionëve ndërmjet marrjes së tyre dhe analizave duhen aplikuar.
3. Numri minimal vjetor i kampionëve përcaktohet sipas madhësisë së impiantit të trajtimit dhe kampionet merren në intervale kohore të rregullta përgjatë vitit:

2 000 deri në 9 999 e.p.	12 kampionë gjatë vitit të parë. Katër kampionë në vitet pasuese, nëse mund të tregohet që uji gjatë vitit të parë respekton dispozitat e Vendimit; nëse një nga katër kampionët nuk i plotëson kërkesat, 12 kampionë duhet të merren vitin që pason.
10 000 deri në 49 999 e.p.	12 kampionë
50 000 e.p. ose më shumë	24 kampionë

4. Ujërat e përdorur të trajtuar presupozohen të respektojnë parametrat përkatës nëse, për çdo parametër përkatës të konsideruar individualisht, kampionët e ujit tregojnë që respektohet vlera parametrike përkatëse në mënyrën e mëposhtme:
  - a. për parametrat e specifikuar në Tabelën 1, një numër maksimal kampionësh që lejohet të mos plotësojë kërkesat,

shprehur në përqendrimet dhe/ose përqindjet pakësimi në atë Tabelë, specifikohet në Tabelën 3;

- b. për parametrat e Tabelës 1 shprehur në përqendrimet, kampionët, që nuk plotësojnë kërkesat, të marrë në kushte normale operimi nuk duhet të devijojnë nga vlerat parametrike prej më shumë se 100%. Për vlerat parametrike në përqendrimin e lidhur me totalin e trupave të ngurtë pezull mund të pranohen deviacione deri në 150 %;
- c. për ato parametra që specifikohen në Tabelën 2 mesatarja vjetore e kampionëve për çdo parameter duhet të respektojë vlerat parametrike përkatëse.

5. Vlerat ekstreme për cilësinë e ujit në fjalë nuk duhet të merren në konsideratë kur ato janë rezultat i situatave të pazakonshme si në rastin e shirave të dendur.

**Tabela 3 Numri maksimal i kampionëve që lejohet të mos plotësojë kërkesat**

Seritë e kampionëve të marrë në cilindo vit	Numri maksimal i kampionëve që lejohet të mos plotësojë kërkesat
4-7	1
8-16	2
17-28	3
29-40	4
41-53	5
54-67	6
68-81	7
82-95	8
96-110	9
111-125	10
126-140	11
141-155	12
156-171	13
172-187	14
188-203	15
204-219	16
220-235	17
236-251	18
252-268	19
269-284	20
285-300	21
301-317	22
318-334	23
335-350	24
351-365	25

## Aneksi II. Kriteret për identifikimin e zonave sensitive

1. Një trup ujqor duhet identifikuar si zonë sensitive nëse bie në një nga grupet e mëposhtme:
  - a. liqenet natyrore me ujëra të ëmbël, trupat e tjerë me ujëra të ëmbël, ujërat estuarë dhe bregdetarë që janë trofikë apo që në të ardhmen e afërt mund të bëhen trofikë nëse nuk merren masa mbrojtëse.

Elementët e mëposhtëm mund të merren parasysh kur konsiderohet se cila lëndë ushqyese duhet pakësuar nëpërmjet trajtimit të mëtejshëm:

- i. liqenet dhe përrrenjtë që arrijnë liqene/rezervuara/gjire të mbyllura që kanë shkëmbime të pakta uji, tek të cilat mund të ndodhë akumulimi. Në këto zona, duhet përfshirë largimi i fosforit në qoftë se nuk mund të demonstrohet që largimi nuk do të ketë efekt në nivelin e trofikimit. Në rastet kur ka shkarkime nga agglomerate të mëdha, duhet marrë në konsideratë edhe largimi i azotit;
- ii. ujërat e grykëderdhjeve, gjireve dhe ujërat e tjerë bregdetarë që kanë shkëmbime të pakta uji ose që marrin sasi të mëdha lëndësh ushqyese. Shkarkimet nga aglomeratet e vogla zakonisht kanë pak rëndësi në këto zona, por për aglomeratet e mëdha largimi i fosforit dhe/ose azotit duhet përfshirë në qoftë se nuk mund të demonstrohet që largimi nuk do të ketë efekt në nivelin e trofikimit;
- b. ujërat e ëmbla sipërfaqësore të destinuara për nxjerrjen e ujit të pijshëm që mund të përmbajë përqendrim nitrati më shumë se 50 mg/l NO<sub>3</sub> siç parashtrohet në dispozitat përkatëse të legjislacionit specifik në lidhje me cilësinë e kërkuar për ujërat sipërfaqësore të destimuar për nxjerrjen e ujit të pijshëm nëse nuk merren masat e nevojshme;
- c. zonat në të cilat është e nevojshme të kryhet trajtim i mëtejshëm përveç trajtimit sekondar apo ekuivalent me qëllim që të përmbushen kërkesat e legjislacioneve të tjera.

### **Aneksi III. Kërkesat për ujërat e përdorur industrialë**

1. Ujërat e përdorur industrialë që hyjnë në sistemin kolektor dhe impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur i nënshtrohen atij lloj para-trajtimi siç kërkohet me qëllim që të:
  - a. mbrohet shëndeti i stafit që punon në sistemet kolektore dhe impiantet e trajtimit,
  - b. sigurohet që nuk janë të dëmtuara sistemet kolektore, impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur dhe paisjet e lidhura me to,
  - c. sigurohet që nuk pengohet operimi i impiantit të trajtimit të ujërave të përdorur dhe trajtimi i llumit,
  - d. sigurohet që shkarkimet nga impiantet e trajtimit nuk kanë efekte negative në mjedis, apo nuk parandalojnë ujërat pritëse të respektojnë legjislacionet e tjera,
  - e. sigurohet që llumi mund të asgjësohet në mënyrë të sigurt e të pranueshme për mjedisin.

#### **Aneksi IV. Sektorët industrialë të referuar në Paragrafin 24**

1. Përpunimi i qumështit
2. Prodhimi i produkteve të fruta perimeve
3. Prodhimi i pijeve freskuese dhe mbushja e shisheve
4. Përpunimi i patates
5. Industria e mishit
6. Fabrikat e birrës
7. Prodhimi i alkoolit dhe pijeve alkoolike
8. Prodhimi i ushqimit për kafshët nga produkte bimore
9. Prodhimi i xhelatinës dhe ngjitësit nga gëzofët, lëkurat dhe kockat
10. Prodhimi i majasë
11. Industria e përpunimit të peshkut